



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 5781 Prot.

Lezhë, më 01 . 09 . 2021

VENDIM

Nr. 61 Datë 30 . 03 . 2021

Për

“ Miratimin e shembjes së detyruar të shtëpive individuale me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5, në Bashkinë Lezhë, të cilat sipas Akt-Ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit duhen prishur tërësisht dhe të rindërtohen nga e para.”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2 , nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” , nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d " , nenit 57, nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “ Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Nr. 09, date 16.12.2019 "Per perballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimi Këshillit Bashkiak Nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 141, datë 14.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 17, datë 03.02.2021 “ Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI :

1. Miratimin e shembjes së detyruar të shtëpive individuale me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5, në Bashkinë Lezhë, të cilat sipas Akt-Ekspertizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit duhen prishur tërësisht dhe të rindërtohen nga e para, sipas listës bashkëlidhur pjesë e pandarë e këtij vendimi (Aneksi nr.1).

- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën (1) të këtij vendimi sipas legjislacionit në fuqi.
3. Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Sherbimeve Publike , Infrastrukturës dhe Mjedisit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.
 4. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë për oren dhe vendin e prishjes së objektit.
 5. Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit .
 6. Për këtë vendim të njoftohen nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Lezhë të gjithë subjektet të cileve do ju shembet shtëpia individuale sipas afateve ligjore në fuqi.
 7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Kryetari i Bashkisë Lezhë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Infrastruktures dhe Mjedisit, Drejtoria Emergjencave Civile.
 8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 , të nenit 55 , të ligjit nr . 139/2015 , “ Për vetëqeverisjen vendore ”, të ndryshuar .

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI

ERNEST RAKAJ

